# UNIVERSITETI I MITROVICËS
# “ISA BOLETINI”

## RAPORT PËRMBLEDHËS NGA VLERËSIMET NË UMIB
## VITI AKADEMIK 2018-2019

## ZYRA PËR SIGURIMIN E CILËSISË

**Mitrovicë, 2019**

PËRMBAJTJA

Vlerësimi i cilësisë dhe historiku i realizimit të instrumenteve vlerësuese ..... 4

I. Pyetësori me stafin administrativ të UMIB ..... 6

a) Ecuria e pyetësorit..... 6

b) Gjetjet nga pyetësori ..... 6

II. Pyetësori me të diplomuarit e UMIB – ALUMNI..... 11

a) Ecuria e pyetësorit..... 11

b) Gjetjet nga pyetësori ..... 11

III. Pyetësori me stafin akademik ..... 15

a) Ecuria e pyetësorit..... 15

b) Gjetjet nga pyetësori ..... 15

IV. Rekomandime ..... 20

## Lista e shkurtesave:

| | |
|---|---|
| **UMIB** | Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” |
| **IAL** | Institucion i Arsimit të Lartë |
| **AKA** | Agjencia e Kosovës për Akreditim |
| **PYETËSORË** | Pyetësorët për të cilët është hartuar ky raport<br>• Pyetësori me stafin akademik,<br>• pyetësori me administratën dhe<br>• pyetësori me ALUMNI |
| **ZSCUM** | Zyra për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” |

# RAPORT PËRMBLEDHËS PËR VLERËSIMIN E CILËSISË
# VITI AKADEMIK 2018-2019

## Vlerësimi i cilësisë dhe historiku i realizimit të instrumenteve vlerësuese

Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" (këtu e tutje: UMIB), si Institucion i Arsimit të Lartë (Këtu e tutje: IAL) themeluar që nga viti 2013, vazhdimisht ka bërë përpjekje në zhvillimin e një sistemi për sigurimin e cilësisë dhe transparencën e këtij sistemi dhe proceseve që e shoqërojnë atë. Për çdo vit, në UMIB janë organizuar pyetësor me studentët dhe akterë të tjerë relevant, të cilët janë përgjigjur në pyetjet të cilat kanë pasur për qëllim të tregojnë saktë gjendjen reale në UMIB përmes perceptimit të respondentëve. Që nga themelimi e deri më tani, në UMIB është krijuar një gjendje e re, ku përveç hapësirës së re universitare – kampusit të ri, akreditimit të programeve unike për Kosovën, aktiviteteve të shumta që zhvillohen, tashmë kanë diplomuar edhe gjeneratat e para të këtij institucioni në të gjitha njësitë akademike. Poashtu, edhe numri i stafit akademik dhe atij administrativ ka qenë në rritje nga viti në vit. Në të njëjtën kohë, UMIB e konsideron veten si një faktor kontribuues në komunitet dhe më gjerë prandaj ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm të marrëveshjeve jo vetëm më IAL-të por edhe me ndërmarrje dhe institucione të tjera prodhuese. Kjo ka sjellë deri tek një situatë të re faktike, me ç'rast numri i akterëve relevantë të cilët UMIB ka konsideruar se duhet të japin përshtypjet e tyre në lidhje me proceset që zhvillohen në institucion, është zgjeruar dukshëm.

UMIB ka mekanizmat e tij për matjen e cilësisë, dhe përveç që procesi matet dhe monitorohet në vazhdimësi nga ana e dekanëve, prodekanëve, koordinatorëve për cilësi në kuadër të fakulteteve, Zyra për Sigurimin e Cilësisë e Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" (Këtu e tutje: ZSCUM) ka një rol të veçantë në këto zhvillime, dhe është organi kryesor brenda UMIB për matjen e cilësisë së brendshme.

Në përfundim të vitit akademik 2018-2019, në vazhdën e aktiviteteve për të përmirësuar cilësinë brenda UMIB-it, përmbushjen e obligimeve të institucionit karshi rekomandimeve të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (këtu e tutje: AKA), me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve në UMIB, përmirësimit të mësimdhënies si një proces vazhdimisht i ndryshueshëm përkitazi me metodologjitë e reja, dhe rritjes së përgjegjësisë së stafit menaxhues, ZSCUM-ja ka realizuar tre pyetësorë me:

- Stafin akademik (profesorë dhe asistentë) të UMIB-it;
- Stafin administrativ të UMIB-it; dhe,
- Të diplomuarit – ALUMNI.

I gjithë procesi i hartimit të pyetësorëve, lansimit të tyre dhe mbledhjes së të dhënave është bërë nga ZCSUM-ja. Procesi ka qenë transparent, dhe të gjithë pyetësorët kanë qenë anonim duke respektuar kështu dinjitetin e secilit respondent dhe ruajtur prestigjin e institucionit.

Në vazhdim, paraqiten rezultatet e përmbledhura të dala nga të tre pyetësorët. Rekomandimet si pjesa e fundit e tij, përmbajnë edhe sugjerimet për përmirësim, të cilat janë marrë në konsideratë përgjatë procesit të rishikimit të dokumenteve të rëndësishme në UMIB, si Plani strategjik, Plani për zhvillimin e personelit akademik, Hartimin e dokumenteve të nevojshme për stafin akademik dhe studentët e UMIB-it, etj.

# I. Pyetësori me stafin administrativ të UMIB-it

### *a) Ecuria e pyetësorit*

Pyetësori me stafin administrativ është administruar nga ana e ZSCUM-së, përmes pyetësorëve në formë fizike. Në këtë pyetësor janë përgjigjur 37 punëtorë administrativ, duke përfshirë ata të administratës qëndrore dhe atë të njësive akademike. Ky pyetësor, si gjithë të tjerët ka qenë vullnetar dhe anonim.

Pyetësori i hartuar nga ZSCUM, ka përmbajtur 20 pyetje me alternativa, me vetëm një mundësi zgjedhjeje, dhe ka pasur një pyetje të hapur për komente shtesë, sugjerime apo ankesa. Pyetjet kanë pasur për qëllim që të shohin këto aspekte kryesore:

- Kushtet e punës dhe roli i UMIB-it në to;
- Motivacioni në punë;
- Stafi administrativ dhe politikat e UMIB, prej informimit e deri tek vendimmarrja;
- Bashkëpunimi mes administratës dhe nivelit menaxherial të UMIB-it;
- Bashkëpunimi mes administratës dhe studentëve;
- Bashkëpunimi mes administratës dhe stafit akademik.

### *b) Gjetjet nga pyetësori*

Pjesëmarrja e stafit administrativ në pyetësorë konsiderohet e kënaqshme. Stafi nuk ka hezituar të përgjigjet, dhe nuk ka dhënë përgjigje selektive në disa pyetje, dhe t'u shmanget pyetjeve tjera. Poashtu, nga komentet të cilat i kanë dhënë në pjesën e pyetjes së hapur, është vërejtur se stafi administrativ i njeh qartë proceset brenda UMIB-it, dhe është i vetëdijshëm për politikat, proceset dhe sfidat e institucionit.

Gjetjet kryesore, në disa nga pyetjet dhe fushat specifike, nga pyetësori i realizuar me stafin administrativ, konsistojnë si vijon:

Në pyetjen se sa është stafi administrativ i njoftuar me misionin e UMIB, ku qëllimi i pyetjes ka qenë që të shikohet se stafi a ka konceptuar qartë ofrimin e shërbimeve përkitazi me këtë mision, ai është përgjigjur si në tabelën më poshtë:




Stafi administrativ ka vlerësuar pozitivisht raportin e tyre me studentët e të gjitha niveleve në UMIB, dhe këtë e dëshmon tabelë e më poshtme:



Ndonëse pajtohen me mbi 51% si në tabelën më poshtë, për dallim nga dy tabelat e lartë cekura ku “pajtohem plotësisht” dominonte përgjigjet, përgatitja profesionale e stafit administrativ konsiderohet e kënaqshme, me mundësi të përmirësimit.




Relativisht pajtues duket raporti mes stafit administrativ dhe atij akademik:



UMIB vazhdon të jetë vend mbresëlënës për stafin administrativ:




Menaxhmenti, si i lartë ashtu edhe ai i njësive akademike, duhet më tepër të marrë parasysh sugjerimet e stafit administrativ:



Nevoja për trajnime profesionale është e dukshme:




Stafi i administratës, me qëllim që UMIB të përmirësoj edhe më tepër shërbimet e tij, ka ofruar edhe sugjerime, ndër të cilat vlen të përmenden:

- Angazhim më i madh i stafit akademik në punën praktike me studentë;
- Rritja e numrit të të punësuarve në administratë, sepse, vëllimi i punëve është duke u rritur vazhdimisht;
- Të ketë trajnime më të shpeshta të stafit administrativ, sidomos në fushën e teknologjisë;
- Të ri-shikohen disa politika dhe rregullore të UMIB për më shumë efikasitet në punë.

## II. Pyetësori me të diplomuarit e UMIB – ALUMNI

### *a) Ecuria e pyetësorit*

Pyetësori me të diplomuarit e UMIB-IT, ALUMNI është hartuar dhe lansuar nga ana e ZSCUM-së. Në këtë pyetësor janë përgjigjur 148 ALUMNI, ish studentë të UMIB-it që tashmë janë të regjistruar në sistemin ALUMNI, në SMU. Ky pyetësor, si gjithë të tjerët ka qenë vullnetar dhe anonim.

Pyetësori ka përmbajtur 11 pyetje me alternativa, me vetëm një mundësi zgjedhjeje, dhe ka pasur një pyetje të hapur për komente shtesë, sugjerime apo ankesa. Pyetësorët janë lansuar përmes online platformës, dhe poashtu rezultatet janë gjeneruar në mënyrë automatike. Pyetjet kanë pasur për qëllim që të shohin këto aspekte kryesore:

- A kanë korresponduar përmbajtja e studimeve në UMIB me vendin e tyre të punës;
- A është UMIB-i, IAL që përgatitë studentët për tregun e punës;
- Sa ka arritur UMIB që të përgatisë për jetën post-diplomike studentët.

### *b) Gjetjet nga pyetësori*

Pjesëmarrja e ALUMNI në pyetësorë konsiderohet e kënaqshme. Të diplomuarit nuk kanë hezituar të përgjigjen, dhe nuk kanë dhënë përgjigje selektive në disa pyetje, dhe t'u shmangen pyetjeve tjera. Poashtu, nga komentet të cilat i kanë dhënë në pjesën e pyetjes së hapur, është vërejtur se ALUMNI është ngushtë i lidhur me UMIB, dhe nga sugjerimet e tyre vërehet qartë qasja kritike për të përmirësuar atë që ka munguar gjatë jetës së tyre studentore.

Gjetjet kryesore, në disa nga pyetjet dhe fushat specifike, nga pyetësori i realizuar me ALUMNI, konsistojnë si vijon:

Në pyetjen se Studimet më përgatitën mirë për karrierën time aktuale, të diplomuarit e UMIB-it kanë dhënë përgjigje të kënaqshme, ku shumica prej tyre pajtohen se institucioni ka dhënë kontribut të çmuar në këtë drejtim:




Ndërsa, në lidhje me atë se sa mund të aplikohet dija që është marr në UMIB me punën e tyre pas diplomimit, studentët janë si shumicë janë pajtuar që ka një përputhje, ndonëse, ka një përqindje e cila nuk pajtohet me këtë:



Pothuajse është e njëjtë gjendja edhe tek përgjigja e të diplomuarve në lidhje me atë se, dijet e tyre të marra na UMIB sa shërbejnë në jetën e përditshme:




Përshtypja ë të diplomuarve për UMIB-in është e mirë, dhe kjo vërehet tek rekomandimi që studentët bëjnë për të tjerët, që ky institucion të jetë zgjedhja e parë për të studiuar:




Shqetësues mbetet fakti se, përqindja më e madhe e të diplomuarve është e pa punë, me ç'rast vetëm 26% e tyre kanë deklaruar se kanë një vend pune. Megjithatë, kjo i referohet studentëve që kanë marrë pjesë në këtë vlerësim. Sipas të dhënave nga Fakulteti i Edukimit, përqindja e të punësuarve pas diplomimit është në shkallën 86 %.

ALUMNI, me qëllim që UMIB-i të përmirësojë edhe më tepër shërbimet e tij, ka ofruar edhe sugjerime, ndër të cilat vlejnë të përmenden:

- Rritja e mundësive për punë praktike për studentët;
- Raporti mes profesorëve dhe studentëve të jetë raport më i afërt;
- Të ketë më shumë hapësirë për punë kërkimore shkencore nga ana e studentëve gjatë studimeve të tyre;
- Vizita më të shpeshta në institucione nga të cilat studentët do të mund të përfitonin.

## III. Pyetësori me stafin akademik

### *a) Ecuria e pyetësorit*

Pyetësori me stafin akademik të UMIB është hartuar dhe lansuar nga ana e ZSCUM-së. Në këtë pyetësor janë përgjigjur 54 profesorë dhe asistentë, të gjithë në marrëdhënie të rregullt pune në UMIB. Ky pyetësor, si gjithë të tjerët ka qenë vullnetar dhe anonim.

Pyetësori ka përmbajtur 23 pyetje me alternativa, me vetëm një mundësi zgjedhjeje, dhe ka pasur dy pyetje të hapura për komente shtesë, sugjerime apo ankesa. Pyetësorët janë lansuar përmes platformës online, dhe poashtu rezultatet janë gjeneruar në mënyrë automatike. Pyetjet kanë pasur për qëllim që të shohin këto aspekte kryesore:

- Organizimi i brendshëm i institucionit;
- Procesi i mësimdhënies dhe puna kërkimore;
- Bashkëpunimi mes stafit akademik dhe nivelit menaxherial: të njësisë dhe atij në nivel qendror;
- Informimi dhe procesi i vendimmarrjes;
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional dhe përkrahja e UMIB;
- Kushtet e punës: simulimi, motivimi dhe sjellja.

### *b) Gjetjet nga pyetësori*

Pjesëmarrja e stafit akademik në pyetësorë nuk konsiderohet e kënaqshme, meqë në të kanë marrë pjesë vetëm 50% e të gjithë stafit. Prej atyre që janë përgjigjur, nuk ka pasur hezitime të përgjigjen, dhe nuk kanë dhënë përgjigje selektive në disa pyetje, dhe t'u shmangen pyetjeve tjera. Poashtu, nga komentet të cilat i kanë dhënë në pjesën e pyetjes së hapur, është vërejtur se stafi akademik është ngushtë i lidhur me UMIB-in, njeh proceset që zhvillohen brenda tij, dhe nga sugjerimet e tyre vërehet qartë qasja kritike për të përmirësuar proceset e filluara.

Gjetjet kryesore, në disa nga pyetjet dhe fushat specifike, nga pyetësori i realizuar me stafin akademik, konsistojnë si vijon:

- Stafi akademik është mirë i informuar me misionin e UMIB;
- Stafi akademik, relativisht mirë është i informuar me vendimet që merren brenda UMIB;
- Ndonëse duket i kënaqshëm, komunikimi mes stafit akademik dhe atij jo akademik duhet të intensifikohet për të mirë;
- Ka një nevojë më të madhe të mbajtjes së trajnimeve profesionale;

- Mësimdhënia dhe puna kërkimore shkencore duhet të baraspeshohet;
- UMIB duhet ta pasurojë bibliotekë fizike të tij, dhe të krijojë qasje në databaza elektronike.

Në paraqitje tabelore, disa nga gjetjet e lartë shënuara do të dukeshin me sa vijon:

2. Unë jam mirë i/e informuar për misionin e Universitetit në të cilin punoj.

54 responses




7. Unë jam mirë i/e informuar për të gjitha vendimet që merren në Universitet

54 responses



8. Komunikimi në mes të personelit akademik dhe personelit jo akademik të fakultetit është i kënaqshëm

54 responses



12. Unë kam qasje të shpeshta në trajnime profesionale të organizuara nga fakulteti apo nga UMIB

54 responses




15. Raporti në mes punës kërkimore/hulumtuese  dhe mësimdhënies në fakultet është i kënaqshëm

54 responses



17. Fakulteti posedon bibliotekë të pasur me numër të mjaftueshëm të librave në fakultetin ku unë punoj.

54 responses




Stafi akademik, me qëllim që UMIB-i të përmirësojë edhe më tepër shërbimet e tij, ka ofruar edhe sugjerime, ndër të cilat vlejnë të përmenden:

- Organizimi i trajnimeve profesionale;
- Ngritja e nivelit të përgjegjësisë së mësimdhënësve dhe menaxhmentit;
- Të krijohen mundësi shkëmbimi të stafit akademik me IAL ndërkombëtare;
- Takime të gjera më të shpeshta të stafit akademik për të diskutuar në lidhje me mësimdhënien, punën hulumtuese dhe vetë UMIB-in;
- Promovimi më i madh i UMIB-it;
- Të stimulohen më shumë studentët përmes aktiviteteve të ndryshme;
- Trajnime të stafit për metodologji të mësimdhënies;
- Të rritet përkrahja e UMIB-it për stafin akademik për punën hulumtuese dhe studime jashtë vendit;
- Të rritet bashkëpunimi mes njësive akademike të UMIB përmes organizimeve të përbashkëta;

# IV. Rekomandime

Zyra e cilësisë e UMIB-it, pasi ka shqyrtuar të tre pyetësorët dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve, në këtë fazë të zhvillimit të institucionit, i rekomandon menaxhmentit të lartë të UMIB-it, menaxhmentit të njësive akademike, stafit akademik dhe atij administrativ që të merren hapat si më poshtë:

- Të rritet përfshirja e stafit akademik, stafit administrativ dhe e studentëve në proceset e konsultimit të gjerë për vendosjen e politikave në UMIB;
- Të punohet në drejtim të përafrimit sa më të madh të pjesës së mësimdhënies me komponenten e hulumtimit;
- Të organizohen trajnime sistematike për metodologjitë e reja të mësimdhënies për profesorët dhe asistentët e UMIB;
- Stafi akademik të stimulohet për të qenë pjesë e projekteve ndërkombëtare
- Të bëhen të mundura organizimi i trajnimeve profesionale për stafin administrativ;
- Të rritet procesi i llogaridhënies tek menaxhmentet e njësive akademike, menaxhmenti i lartë si dhe vet stafi akademik dhe ai administrativ;
- UMIB të përfshihet në marrëveshje për shkëmbim të stafit akademik me universitete ndërkombëtare;
- Për çdo rishikim të kurrikulave, UMIB-i të mbështetet në rezultate të ofruara nga pyetësorët me ALUMNI me qëllim që të merret për bazë perceptimi i tyre për atë se çka duhet t'i shtohet programeve të UMIB;
- Të rritet numri i instrumenteve të përdorura duke përfshirë edhe punëdhënësit
- UMIB-i të përafrojë sa më shumë programet e tij me specifika të tregut të punës;
- Të bëhet një proces i matjes së lidhjes mes pjesës teorike dhe asaj praktike gjatë mbajtjes së lëndëve mësimore;
- UMIB-i të bëhet pjesë e sa më shumë marrëveshjeve në mes tij dhe institucioneve të cilat do të mundësonin punën praktike për studentët;
- UMIB-i të inkurajojë përmes takimeve më të shpeshta, bashkëpunimin në mes njësive akademike, me qëllim të ngritjes së multidisiplinaritetit në organizime akademike.